



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Maj 2021

Nr. 363

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi

Kërkues: Partia Demokratike, Dega Gjirokastrë

Ndaj: Kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi

Baza Ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2 e 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve nga Partia Demokratike, Dega Gjirokastrë, në datën 03.04.2021, është raportuar denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2803, ndaj kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi. Denoncuesi pretendon se, prej më shumë se dy javësh, pa një vendim të kryetarit të bashkisë, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 të



Data: 21 Maj 2021
Nr: 363

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë vendosur në vende publike materiale propagandistike, nga Partia Socialiste.

Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka vënë në dispozicion edhe disa foto me qëllimin për të provuar pretendimet e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datën 03.04.2021 në portalin e denoncimeve të KQZ-së, është raportuar denoncimi i Partisë Demokratike, Dega Gjirokastër, ndaj kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi, për shkelje të nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3, pika 1 dhe 7, të udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas denoncuesit z. Çuçi ka vendosur në vende publike materiale propagandistike, pa një vendim të miratuar të Kryetarit të Bashkisë, për përcaktimin e vendeve të lejuara për këtë fakt.

Me shkresën nr. 4258 prot., datë 22.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, informacion lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi.



Me shkresën nr. 4070 prot., datë 20.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 4200 prot., datë 22.04.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Gjirokastrë, z. Nertil Nebiaj, i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, një kopje të vendimit të Bashkisë Gjirokastrë, lidhur me detyrimin e përcaktuar në nenin 79, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, mbi afishimin e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore.

III. Analiza ligjore

Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhor çmon se:

Referuar nenit 79, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.”

Referuar nenit 3, pika 1 dhe 7, të udhëzimit nr. 6/2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, parashikohet se:

1. Kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë para datës së zgjedhjeve, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Materialet propagandistike zgjedhore lejohet të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.

7. Vendimi i kryetarit të bashkisë për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit dhe një kopje e tij i njoftohet Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet brenda 24 orësh nga miratimi i tij. Vendimet e marra nga kryetarët e bashkive përpara miratimit të këtij udhëzimi rishikohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.”



Për sa më sipër, referuar shkresës nr. 4070 prot., datë 20.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 4200 prot., datë 22.04.2021, nëpërmjet së cilës Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Gjirokastrë, z. Nertil Nebiaj, i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, një kopje të vendimit nr. 18, datë 02.03.2021, të Bashkisë Gjirokastrë, rezulton se detyrimi ligjor dhe nënligjor i kësaj bashkie për të përcaktuar vendet publike se ku do të afishohen materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet në Kuvend të datës 25 Prill 2021, është përmbushur.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, e 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet z. Bledar Çuçi.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

